



Pranuar / Dorezuar Primijsenol/Prodato Received/Deliverty	28.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTAK	8552/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.970/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.970/2022 të datës 03.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit/Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.970/2022 e datës 03.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.XII/290 i datës 04.11.2022, i Komisionit Vlerësues të Komunës së Obiliqit si dhe Njoftimi Nr.XII/282 i datës 28.10.2022 për rezultatet e vlerësimit i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit.

A r s y e t i m

Komuna e Obiliqit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 03.08.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 25.08.2022 ka shpallur për aplikim konkursin e jashtëm, për emrin e grupit

"Specialistë të Shkencave shoqërore" me numër të referencës RN00009663 lidhur me pozitën *"Zyrtar për biblioteka 4"*, Sektori për Kulturë, për klasën e pozitës Profesional 3.

Ankuesja me datën 31.08.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë e përfshirë deri tek faza e testimit me shkrim, ndërsa bazuar në renditjen perfundimtare të kandidatëve të Komisionit të vlerësimit, e gjeneruar tek SIMBNJ me datën 28.10.2022, e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 54.2 pikë, duke u renditur e nënta (9) në listën perfundimtare.

E pa kënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit-CV-së (biografisë) nga ana e komisionit të vlerësimit, me datën 28.10.2022 ka parashtruar ankesë, tek komuna e Obiliqit konkretisht Zyra e Burimeve Njerëzore, me pretendimet ankimore se e njëjta është vlerësuar në këtë fazë të vlerësimit nga ana e komisionit vetëm me 9.2 pikë, edhe pse thotë se i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe se me këtë rast nuk i është dhënë mundësia për pjesëmarrje në intervistën me gojë, sipas shpalljes së procedurës së lartcekur.

Me datën 04.11.2022, Komisioni për vlerësim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Obiliqit, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.XII/290, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin lidhur me shpalljen e rezultateve të vlerësimit me Nr.XII/282 të datës 28.10.2022.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e komisionit të vlerësimit në Komunën e Obiliqit, lidhur me refuzimin e ankesës së saj, me datën 03.11.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6664/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se e njëjta është vlerësuar në këtë fazë të vlerësimit nga ana e komisionit vetëm me 9.2 pikë, edhe pse thotë se i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe se me këtë rast nuk i është dhënë mundësia për pjesëmarrje në intervistën me gojë, sipas shpalljes së procedurës së lartcekur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.11.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa me datën 21.11.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Obiliqit lidhur me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 15.12.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.192/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses dhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:6664/2022 të datës 03.11.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 28.10.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit; Përgjigjen në ankesë të datës 26.10.2022 për ankuesen; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Dokumentet e ankueses të gjeneruara tek SIMBNJ; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.11.2022



nga Komuna e Obiliqit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me numër RN00009663 të datës 03.08.2022; Listën e aplikantëve të cilët kanë aplikuar për këtë pozitë e gjeneruar tek SIMBNJ; Formularët e vlerësimit për ankuesen dhe kandidaten e për zgjedhur te gjeneruara tek SIMBNJ; Njoftimin me numër Nr.XII/236 të datës 14.09.2022 mbi listën e ngushtë; Vendimin me numër Nr.II1227 të datës 08.09.2022 nga Kryetari i Komunës së Obiliqit; Vendimin me numër II1230 të datës 12.09.2022 nga Kryetari i Komunës së Obiliqit; Renditjen përfundimtare te kandidatëve të datës 28.10.2022 e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin me numër Nr.XII/282 të datës 28.10.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Ankesën e ankueses të datës 28.10.2022 e parashtruar tek Komuna e Obiliqit; Vendimin Nr.XII/290 të datës 04.11.2022 të Komisionit për Pranim; Aplikacionin e kandidates së për zgjedhur L.Th.G të datës 25.08.2022 së bashku dëshminë mbi përgatitje profesionale dhe atë të punës, Aplikacionin e ankueses të datës 31.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Vendimin me numër VK.nr.192/2022 të datës 15.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe E-mailat zyrtar të datës 20.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e pa bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „*Specialist të shkencave shoqërore*“, në Komunën e Obiliqit, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009663 lidhur me pozitën “Zyrtar për biblioteka 4” në Sektorin për Kulturë, kanë qenë si në vijim:

- **Arsimi i kërkuar:** *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- **Fusha e kërkuar:** *Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të tjera të ngjashme.*
- **Përvoja e punës e kërkuar:** *Nuk kërkohet.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se për pozitën e lartcekur kanë aplikuar tridhjetë e shtatë (37) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë njëzet (20) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesja nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 54.2 pikë gjithsejtë dhe se e njëjta është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: “ 1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”, ndërsa pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses se e njëjta nuk është vlerësuar meritoreisht edhe pas kompletimit të dokumentacionit lidhur me dëshminë e punësimit(trustin) thotë se është vlerësuar me vetëm 9.4 pikë, Kolegji ka konstatuar se ky

pretendim është i pa bazuar, pasi që në rastin konkret ankuesja me datën 28.10.2022 sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ, është njoftuar lidhur me rezultatet e vlerësimit për pozitën e lartcekur, e cila ka fituar pikët e përgjithshme prej gjithsejtë 54.2 pikë, duke u renditur e nënta (9) në listën përfundimtare të këtij njoftimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, e cila pretendon se gjatë këtij procesi nuk është vlerësuar meritorisht dhe të njëjtës nuk i është dhënë mundësia për pjesëmarrje në intervistën me gojë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafit 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: *"1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet"*, ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit në bazë të listës mbi Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 28.10.2022 e gjeneruar tek SIMBNJ, ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët, me ç' rast ankuesen e ka vlerësuar me 9.2 pikë, ndërsa lidhur me pretendimin ankimor ku ankuesja deklaroi se i ka bashkangjitur dëshminë e punësimit (trustin), Kolegji ka analizuar dosjen e ankueses e dorëzuar me rastin e aplikimit, ku e njëjta si dëshmi të përvojës profesionale ka dorëzuar: Diplomën me numër Nr.69/13 të datës 05.07.2013, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik-Departamenti Menaxhment dhe Informatikë në Biznes në Kolegjin Universitar "Biznesi" në Prishtinë dhe ka marrë titullin BA i menaxhmentit dhe informatikës në biznes; Diplomën me numër Nr.21/16 të datës 26.06.2016, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet master në Kolegjin Biznesi në Prishtinë-Programi Menaxhment dhe Financa" dhe ka marrë titullin Master i arteve në menaxhment dhe financa, si dëshmi mbi trajnimet e njëjta ka dërguar Certifikatën e lëshuar nga IAS Professional Accounting and Taxi Services, sipas së cilës ankuesja ka ndjekur trajnimin në "Kontabiliteti dhe tatimet praktike" me kompjuter të mbajtur nga data 08.10.2015 deri më 15.12.2015, ndërsa sa i përket dëshmisë mbi përvojën e punës, Kolegji ka vlerësuar se e njëjta nuk është vlerësuar lidhur me këtë pjesë, meqë me konkurs nuk është kërkuar përvoja e punës. Andaj bazuar në këtë konstatim del se Komisioni i Vlerësimit ankuesen e ka vlerësuar vetëm për pjesën e përvojës profesionale dhe trajnimit bazuar si në dëshmitë me lartë të bashkangjitura nga ankuesja me rastin e aplikimit dhe në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se Komisioni i Pranimin vlerësimin për këtë pjesë e ka bërë në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafit 4 nën paragrafit 4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë edhe pretendimet ankimore të ankueses lidhur me këtë pjesë janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, me datën 28.10.2022 ka publikuar Rezultatet e vlerësimit lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, për grupin e pozitivave „Specialist të Shkencave Shoqërore" lidhur me pozitën "Zyrtar për biblioteka 4", në Sektorin për Kulturë në Komunën e Obiliqit, për klasën e pozitës Profesional 3, në të cilën janë përfshirë emrat e kandidatëve sipas pikëve të arritura dhe e përzgjedhur në këtë pozitë si kandidatja më e suksesshme është shpallur L.Th-G me gjithsejtë

75.6 pikë të arritura, andaj ndërlidhur me këtë ,Kolegji konstaton se publikimi nga ana e Njësisë së Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se : *“2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues”* dhe në këtë kuptim ankuesja është renditur e nënta (9) në këtë listë me gjithsejtë 54.2 pikë të arritura, e që bazuar në dispozitën e lartcekur e njëjta nuk ka arritur të mbledh pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur në radhët e kandidatëve fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga Komuna e Obiliqit lidhur me dosjet e kandidatës së përzgjedhur lidhur me pozitën e lartcekur dhe ka konstatuar se Komisioni i Pranimit me rastin e përzgjedhjes së kandidatës L.TH-G, e cila ka grumbulluar pikë më së shumti në raport me kandidatët e tjerë, për emrin e grupit *„Specialist të Shkencave Shqoqërore”* lidhur me pozitën *“Zyrtar për biblioteka 4”*, Sektori për Kulturë, për klasën e pozitës Profesional 3, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se:” neni 24. *Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit ”.* Ndërsa ndërlidhur me dëshmitë e dorëzuara të dosjes së kandidatës së përzgjedhur nga kjo procedurë e rekrutimit, Kolegji ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur L. T-Gë, posedon Diplomën me numër Nr.018/21 të datës 04.08.2021, të lëshuar nga Kolegji i Menaxhmentit Internacional në Podujevë me të cilin dëshmohet se me datën 28.07.2021 ka përfunduar studimet në programin Biznes dhe Menaxhment me specializim Menaxhment Gjeneral Internacional dhe ka marrë titullin Bachelor i Arteve në Biznes dhe Menaxhment Gjeneral Internacional, ndërsa lidhur me përvojën e punës së kandidatës së përzgjedhur, Këshilli nuk është lëshuar në shqyrtim të dosjes së saj lidhur me këtë pjesë, meqenëse nuk është kërkuar me konkurs lidhur me pozitën e lartcekur. Andaj ndërlidhur me këtë, Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur L. Th-G i plotëson kushtet e konkursit lidhur me pozitën e lartcekur për fushën e arsimit të caktuar, ngase e njëjta ka ofruar dëshmi se posedon diplomën lidhur me përfundimin e studimeve themelore nga fusha e cila është kërkuar me konkurs.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunën e Obiliqit, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas Njoftimit me numër Nr.XII/282 të datës 28.10.2022 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit për emrin e grupit *„Specialist të Shkencave Shqoqërore,* në Komunën e Obiliqit, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009663 lidhur me pozitën *“Zyrtar për biblioteka 4”*, Sektori për Kulturë, për klasën e pozitës Profesional 3, si dhe Vendimi me numër Nr.XII/290 i datës 04.11.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Obiliqit , kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.970/2022, datë 28/12/2022

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

